

Data 26.06.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje mjete teknologjike

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Automjete
34100000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 3.000.000 (tre milion) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gjirokaster** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

c. *Formulari i ofertes*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

.....
(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022-2023-2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislationit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20. % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit me shpenzimet e veta

2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë për plotësimin e specifikimeve të vendosura nga ana e AK

2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ngarkojë në SPE foto të automjetit si dhe të lejes së qarkullimit së kësaj të fundit ku të jenë të evidentueshme secila prej specifikimeve të kërkuara nga ana e AK

2.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë për garancinë e automjetit për një periudhë 3 vjetore nga data e dorëzimit tek autoriteti kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIME TEKNIKE TË MJETIT TEKNOLOGJIK:

Viti i prodhimit :	2009 e larte (2010,2011..)
Lenda djegese	Naftë
Kamio:	Manuale
Timoni:	Majtas
Fuqia motorike:	Min 80 Kw-150 Kw

Kilometra të përshkruara :	Max 150.000 - 250.000km
Vëllimi i motorit:	Min 2200cm ³ - max 3200 cm ³
Pesha bosh:	Min 3000 kg-max 3500 kg
Pesha maksimale me ngarkesë:	5500kg
Vende në kabine:	3 persona
Gjatësia:	Min 6200m- max 6300 m (per shkak te terrenit dhe relievit me rrugica te ngushta dhe te thyera ne pjesen e lartme te qytetit)
Gjerësia:	Min 2050m- max 2100m (per shkak te terrenit dhe relievit me rrugica te ngushta dhe te thyera ne pjesen e lartme te qytetit)
Pesha e ngarkesës qe transporton	Min 1500 – 2000 kg
Përmasat e gomave:	205/75/R16 – 195/75 R16 c
Sistemi i frenimit:	ABS
Vëllimi i vaskës të pjesës teknologjike:	Min 7 – 8 m ³
Gomat e mjetit	90% te pa konsumuara

Numri I akseve 2-(4x2) dopjo gome.

Sistemet baze te mjetit te jene funksional dhe pa problem;

-sistem drejtimi

-sistem frenimi

-sistem trasmesionit kardanik

-sistem pamor dhe zanor

-sistemi I shuarjes se zjarit funksional dhe pa problem.

Klasa e shkarimit te gazrave,sipas legjislacionit ne fuqi,euro 4,euro 5.

Automjeti do te kete garanci difektesh per nje perjudhe 6 gjashte mujore nga dita e dorezimit tek investitori dhe shitesi,do te pergjigjet per riparimin e difekteve jo me vone se tre dite nga data e njoftimit.

Difektet te cilat perfshin perjudha e garancise jane si me poshte;

-difekte motorike

-difekte te kutise se shpejtesise

-difekte te trasmesionit

-difekte te valvulave dhe paketave elektrike

-difekte te pompes se hidraulikut.

Në pjesen teknologjike të ketë të instaluar kompaktor /ngjeshes të mbeturinave dhe nxjerres me piston hidraulik të ngarkeses nga ana e pasme , 2 platforma të pasme ku mund të akomodojë dy operatorë duke përdorur pajisjet e sigurisë , dritat e sinjalizimit në veprim gjatë punës deri në shpejtësinë 20km/orë. Pajisja e ngjeshjes duhet të funksionojë me ane të rrëshqitjes dhe lopatës së llojit që zakonisht quhet“ njëra – teh e artikulluar “ e përbërë si mëposhtë:

- Nga një rrëshqitje e bërë nga materiali I përshtatshëm rezistent ndaj konsumit , I pajisur me një lëvizje drejtvizore të alternuar në udhëzuesit anësorë , të lëvizur nga një pale cilindra me dyveprime.

- Nga një teh I një materiali të përshtatshëm kundër konsumit , I varur ne rrëshqitje , e pajisur me një lëvizje rrotulluese alternative , lëvizur nga një pale e dytë e cilindrave hidraulikë me dyveprim.

Në mënyrë që të përmbahet shtytja në muret anësore të kutisë gjatë ngjeshjes ,dhe për të shmangur mundësinë e grumbullimit të mbeturinave në zonat rrëshqitëse , lëvizja lineare e rrëshqitjes duhet të bëhet në udhëzues.

Udhëzuesit duhet të pozicionohen në mënyrë të jashtme në rezervuar .

Për të kufizuar sforcimet e krijuara në rrëshqitje gjatë ngjeshjes së mbeturinave dhe për të siguruar fërkimin më të ulët të mundshëm ,pale cilindra që kontrollojnë përkthimin duhet të vendosen në të njëjtën aeroplan si të katër këpucët rrëshqitëse .

PAJISJE PËR NGRITJEN E KOSHIT

Pajisja e ngitjes së koshit duhet të jetë e pranishme në pjesën e pasme të rezervuarit dhe duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

- Pajisja duhet të punojë me kinematë e rrotullimi të dyfishtë , I cili parashikon ngritjen e koshit dhe përmbysjen e mëvonshme të së njëjtës , për të shmangur çdo përhapje të mbeturinave në tokë.
 - Kontrolli I pajisjes duhet të bëhet perms distributorit proporcional ,për të optimizuar shpejtësinë e ciklit (të ngadaltë – të shpejtë- të ngadaltë), pa shkaktuar bllokime në strukture dhe koshat.
 - Këndi përmbysës rreth 45 grad, për të siguruar zbrasjen e përsosur të koshit pa pasur nevojë për goditje në fund të goditjes:
 - Sistemi hidraulik duhet të jetë I madhësisë për të garantuar një kapacitet ngritjeje deri në 360 kg.
 - Pajisja duhet të ketë konfigurimin e mëposhtëm:
- a- Ganxhë kapjerafti (krehër) I ZGJATUR sipas UNI EN-840 I cili lejon kapjen e njëkohëshme të dy koshave 40 litra dhe kapjen nga nje kosh me 120 litra ose 240 litra ose 360 litra
 - b- Ganxhëkapje me anë të lidhjes së krahëve , lidhje DIN mashkull , e përshtatshme për kontenjerë me 4 rrota , që kanë një vëllim deri ne 1100;

Mjeti të jetë I pjisur me ;

- Leje qarkullimi
- Targe
- Çertifikat pronësie
- Akt kolaudimi I mjetit
- Siguracion
- Taksavjetore e mjetit.

NJËSI E PROKURIMIT

Rigelsa Alikaj

Bexhet Baxhella

Alfons Alikaj